



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glogoc, me 05.09.2018



RAPORT PËR MUAJIN GUSHT 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar kontrolla të produkteve ushqimore për shkak të festës së Bajramit, kontrollë e transportit publik dhe ndërtimeve pa leje, ku me qëllim të mbikqyerjes së vazhdueshme është kujdestaruar edhe gjatë vikendit në këto tri lëmi.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka filluar punën edhe Inspektorja e Ndërtimit e pranuar sipas kontratës me marrëveshje për shërbime të veqanta. Është bërë ndërprerja e punimeve gjatë ndërtimit të disa objekteve pa leje duke zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme. Gjatë zhvillimit të procedurave, janë hartuar edhe aktvendime për pezullim të punimeve, kufizime me shenja zyrtare, aktvendime për rrënim, kallëzime penale (2 herë) dhe janë shqiptuar edhe gjopa mandatore.

Janë realizuar dy aksione të rrënimit:

Në Parkun e Biznesit dhe përballë tij (pronë e AKP-së), të cilat rrënimë nuk kanë përfunduar tërësisht si pasojë e pengesave në kryerjen e punëve nga Kompania e kontraktuar ndaj të cilës janë shqiptuar dy vërejtje nga drejtoria jonë. Gjatë këtij muaji janë shqyrtuar 9 kërkesa të ndërtimit.

Inspektorët e Komunikacionit kanë vazhduar me kontrolla të transportit rrugor dhe largimin e transportuesve ilegal, e gjithashtu kontrolla të rendit të udhëtimit të Kompanive Transportuese të liçencuara.

Gjatë këtij muaji janë konfiskuar 5 automjete në kohëzgjatje prej 5 ditë dhe 2 palë tabela në kohëzgjatje prej 48 orë. Në shumicën e rasteve gjatë hasjes në transportues ilegal janë shqiptuar gjopa mandatore 13 në vlerë prej 100 euro si dhe 2 gjopa në vlerë prej 75 euro për kompanitë transportuese të liçencuara të cilat kanë bërë shkelje gjatë transportit.

Inspektori i Tregut dhe Sanitar :Gjatë këtij muaji për shkak të festës së Bajramit janë kontrolluar të gjitha subjektet ushqimore dhe është konstatuar një gjendje e mirë e produkteve ushqimore në përgjithësi. Është vazhduar gjithashtu me mirëmbajtjen e tregut javor dhe largimin e tregtarëve që shesin jashtë lokacionit të tregut në rr.Fehmi dhe Xhevë Lladrovci dhe ata në sheshin “Fehmi Lladrovci” të cilët janë larguar duke realizuar aksion me PK-njësi në Drenas. Gjithashtu është vazhduar me inspektime të tjera rreth plotësimit të dokumentacionit për biznes si dhe pompave të derivateve të naftës.

Inspektori i Ambientit ka qenë në pushim vjetor, për punët e tij është autorizuar Inspektori i Komunikacionit, në veqanti gjatë shqyrtimit të kërkesave të palës.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin gusht 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivendime	Gjopa mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kër.	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit Të dyshimt
I.Tregut dhe Sanitar	19	2		2	2	1	1		11 kg
I.Komunikacionit	20		15					2T,5A	
I.Ndërtimit	49	2	3			9	9		
I.Ambientit	8					2	2		
Totali	96	4	18	2	2	12	12	2+5	11 kg

Shtator 2018